

VENDIM
Nr. 65/2020

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe nenit 19/6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Prokurimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Struktura e Komisionit të Prokurimit Publik është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
- II. Organika e Komisionit të Prokurimit Publik është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 29.10.2020

Lidhja 1

ORGANIKA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Pozicioni	Kategoria	Numri i punonjësve
Kryetar		1
Sekretar		1
Nënkryetar		1
Anëtar		3
Këshilltar	II-b	1
Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1
Inspektor	III-a	15
Drejtor	II-b	1
Sektori i monitorimit të zbatimit të vendimeve dhe shërbimit ligjor		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist jurist	III-b	2
Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist IT	III-b	2
Specialist finance/buxheti	III-b	1

Specialist Arkiv-Protokolli	IV-a	1
Redaktor letrar	III-b	1
Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë	III-b	1
Sanitar		1

STRUKTURA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Lidhja 2

